



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 745/11 prot.,

Tiranë, më 11.03.2019

VENDIM  
Nr. 20, datë 11.03.2019

PËR  
NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË PLANIN E PUNËS SË VITIT 2019, TË NJËSISË SË  
AUDITIMIT TË BRENDSHËM, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të Ligjit Nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të Udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë Nr. 27, datë 29.12.2017 “Strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”, të Vendimit Qarkullues të Bordit të Administrimit nr. 7, datë 24.01.2019 “Për miratimin e planit të punës së Njesisë së Auditimit të Brendshëm, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për vitin 2019”, me qëllim realizimin e planit të punës së vitit 2019 sipas programit të auditimit nr. 303/7 datë 04.02.2019 dhe të shkresës së Njesisë-së Auditimit të Brendshëm nr. 303/15 prot., datë 11.03.2019, Bordi i Administrimit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, në mbledhjen e datës 11.03.2019,

VENDOSI:

1. Në grupin e punës për auditimin e “Auditim përputhshmërie në Sistemin e Prokurimeve në Rektorat”, në vend të znj. Bukurie Tafhasi, anëtar grupi do të jetë z. Majlind Shkira.
2. Periudha e auditimit, në “Auditim përputhshmërie në Sistemin e Prokurimeve në Rektorat” do të përfshijë prokurimet e realizuar gjatë vitit 2018, me përjashtim të atyre të audituara më parë.
3. Audituesit do të identifikojnë, analizojnë, vlerësojnë dhe dokumentojnë informacionin e mjaftueshëm për të arritur objektivat e angazhimit, nga ky fakt.
4. Afati i kryerjes së auditimit do të jetë deri më datë 31.03.2019.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Njësia e Auditimit të Brendshëm të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.

KRYETARI  
Adriana BERBERI

*Adriana Berberi*

